



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 260/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë,, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 950 (nëntëqindpesëdhjetë ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 14.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 13.10.2013, rreth orës 12:00, në Rrugën Muharrem Fejza, në hyrje të Lagjes Mati, te rrethi, anëtarë të subjektit politik të AAK-së kanë vendosur posterë mbi rrugë publike, ku i njëjti rast sipas parashtruesit të ankesës theksohet se ka ndodhur edhe në Rrugën Lidhja e Prizrenit në lagjen Tophane në afërsi të shkollës Meto Bajraktari. Parashtruesi i ankesës me këtë rast konsideron se është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, dhe nenit 3 pika b) e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike të cilat ndalojnë vendosjen e posterëve mbi rrugë publike. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi për shkeljen e supozuar.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 17.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.10.2013, në ora 12:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, në të cilën theksohet se vendosja e banerave të AAK-së, nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-së, por mund të jetë bërë nga qytetarë apo individ të paidentifikuar, gjithashtu në përgjigjen në ankesë AAK, thekson se me të pranuar njoftimin për dukjen e banerave të AAK-së mbi rrugë publike, struktura menaxhuese

e fushatës ka bërë largimin e këtyre banerave. Përgjigjes në ankesë AAK, i ka bashkangjitur provat siç janë: Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së, drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së, për respektimin e ligjit mbi zgjedhjet dhe rregulloreve të KQZ-së, fotografitë në të cilat dëshmohet veprimi i largimit të banerave të vendosur mbi rrugë publike të Prishtinës, kërkesën drejtuar shefave të shtabeve zgjedhore për respektim të Kodit Zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteret e subjektit politik të AAK-së, janë vendosur mbi rrugë publike, që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neni 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalojnë vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se, subjekti politik AAK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posteret subjektit të AAK-së, kanë qenë të vendosura në vendet e palejuara për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë posteret nga vendet ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e AAK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posteret e AAK-së, janë vendosur mbi rrugë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik AAK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar

veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 260/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*